



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2345/1 Prot.

Rrëshen me, 04 . 08 . 2020

V E N D I M

Nr. 76 datë 03.08.2020

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË VENDIMIT NR. 83, DATË 29.09.2017 TË KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE PREJ 0.7 KM, NË VENDIN E QUAJTUR EKONOMIA PYJORE/KULLOSORE ULËZ, PJESË E FONDIT PYJOR/KULLOSOR TË BASHKISË MIRDITË, PËR NJË AFAT 1 (NJË) VJEÇAR, SUBJEKTIT “NIKOLLI ENERGY” SHPK, SIPAS RELACIONIT TË SEKTORIT PYJE/KULLOTA, NR. 2331/1 PROT, PËR AMENDIMIN E KONTRATËS SË LIDHUR ME NR. 4738, PROT, DATË 23.10.2017.

Mbështetur në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 54/e, ligjin nr.9385 datë 04.05.2015 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”të ndryshuar, nenet 19, VKM nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive”pika 45, VKM-në nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM- në nr. 1064, date 22.12.2010 , VKM-në nr. 887, datë 19.12.2007 “ Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”, në Udhëzimin nr.1.datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”,pikat 22, 23, dhe 26, VKM nr. 591 datë 09.10.2018 Për disa ndryshime në vendimin nr. 1353 datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionin teknik si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e vëllimit të fondit pyjor” (të ndryshuar), VKM nr. 592 datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr.1374 datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionin teknik si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e vëllimit të fondit kullor” (të ndryshuar) dhe në “Relacion mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Nikolli Energy” shpk. me nr.4092 Prot, datë 11.10.2019 dhe nr.1827 Prot., datë 22.06.2020 për amendimin e kontratës së lidhur me bashkinë Mirditë me nr.4738 prot.datë 23.10.2017, në funksion të ndërtimit të hec-it - Rrëshen, nga subjekti ”Nikolli Energy” shpk.nr.2331/1 prot, datë 28.07.2020, këshilli bashiak pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve të reflektuara në relacionin tekniko-ekonomik mbi shqyrtimin e kerkesës së subjektit “Nikolli Energy” shpk. si më poshtë vijon:
 - **Pika 1.** Miratimin e dhënjes në përdorim me kontratë qiraje prej 0.7 km,(0.25 km për rrugë 0.2 km për linjë gjatësore dhe 0.25 km për kanale dhe tubacione), në ekonominë

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

pyjore/kullosore Ulëz, pjesë e fondit pyjor/kullosor të bashkisë Mirditë, subjektit “Nikolli Energy” shpk; ndryshohet si në pikën 1/1;

- **Pika 1/1**-Miratimin e shtesës për heqje nga fondi pyjor/kullosor në administrim të bashkisë Mirditë të sipërfaqes prej 0.013 ha, n/ngastren nr. 5 b, në ekonominë pyjore “Ulëz”, dhe shtesës për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor në administrim të bashkisë Mirditë të sipërfaqes prej 0.105 ha, n/ngastrat nr. 5 b, në ekonominë pyjore “Ulëz”, në funksion të ndërtimit të hec-it - Rrëshen, nga subjekti “Nikolli Energy” shpk.
 - **Pika 2** - Afati i dhënies në përdorim është 1 (një) vit; ndryshohet si në pikën 2/1.
 - **Pika 2/1** - Afati i dhënies në përdorim do të jetë 2-5 vjet.
 - **Pika 3** - Vlera e qirasë për vitin e parë është 94 250 lekë (nëntëdhjetë e katër mijë e dyqindë e pesëdhjetë) lekë, dhe vlera e bimësisë pyjore, florës dhe faunës në vlerën 2000 lekë; ndryshohet si në **pikën 3/1**.
 - **Pika 3/1**- Shoqëria për periudhën e mbetur, paguan në llogarin e Bashkisë Mirditë, shumën prej 113 450 (njëqindë e trembëdhjetë mijë e katërqindë e pesëdhjetë) lekë/vit.
 - **Pas pikës 3/1** shtohet **pika 3/2**.
 - **Pika 3/2**- Relacionin tekniko-ekonomik mbi shqyrtimin e kerkesës së subjektit “Nikolli Energy” me nr. 2331/1 Prot., datë 28.07.2020 është pjesë e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (drejtoria juridike dhe ASHBVP (sektori pyje/kullota).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ



KRYETAR

Pjeter PJETRI

